



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA E PËRMARIMIT PRIVAT "CORRECTOR"

Nr. 4684 Prot.
Nr. Dosje 1872

Tiranë, më 06/07/2022

URDHËR

"Për vendosjen e sekuestros mbi kuotat e debitorit"

Drejtuar: **QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT, TIRANË**

Për dijeni: **SHOQERIA FABBTEL me Nipt K29824103U**
Gjocaj, Peqin

Unë Armels Lole përmarues gjyqësor pranë zyrës së përmarimit Corrector sh.p.k., pasi studiova materialet e dosjes përmarimore Nr. 1872 bazuar në Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë – Nr. 5874 Vendimi, datë 16/09/2021,

KONSTATOVA:

Se më datë 10/06/2022 është lidhur kontrata e shërbimit midis zyrës së përmarimit Corrector dhe kreditorit Tranzit Shpk, me objekt ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv – Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 5874 Vendimi, datë 16/09/2021 me palë dhe objekt:

- **Kreditor:** Tranzit shpk (Kontrate datë 21/10/2016)
- **Debitorë:** SHOQERIA FABBTEL me Nipt K29824103U
- **Objekti:** Pagesë detyrimi

Për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit, duhet të kryhet vënia e sekuestros mbi çdo pasuri të debitorit me qëllim shlyerjen e detyrimit ndaj kreditorit.

Për sa më sipër, si dhe në zbatim të neneve 519, 527, 560, 563 e në vijim të K.Pr.Civile si dhe të Ligjit Nr.26/2019 "Për Shërbimin Përmarimor Gjyqësor Privat"

URDHËROJ:

1. Vendosjen e sekuestros mbi kuotat e debitorit:

- **SHOQERIA FABBTEL me Nipt K29824103U, me Seli: Gjocaj, Peqin**

duke ndaluar disponimin ose tjetërsimin e kuotave të debitorit, si dhe ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga këto kuota;

2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor;
3. Për personat që bëhen pengesë, do të aplikohet sanksioni i gjobës në shumën 50.000 lekë në zbatim të nenit 606 të K.Pr.Civile si dhe kallëzimi për ndjekje penale në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
4. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, palët e interesuara kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi.

ZYRA E PËRMARIMIT PRIVAT "CORRECTOR"



CORRECTOR
BAILIFF SERVICE

Rruga e Kavajës, Ndërtesa Nr.27, Hyrja 1, Kati i IV, Tiranë, Cel.: +355 68 400061, armels.lole@nchb.al